

AUTORITETI QENDROR BANKAR I KOSOVËS
CENTRALNI BANKARSKI AUTORITET KOSOVA
CENTRAL BANKING AUTHORITY OF KOSOVO


Sistemi i Pagesave në Kosovë

P r i s h t i n ë , 2 0 0 8

Sistemi Ndërbankar i Kliringut

Që nga themelimi, AQBK ka qenë e angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin e një sistemi efikas dhe të sigurt për pagesat vendore. Arritja më e madhe ndodhi në maj të vitit 2001, kur u krijua Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN) me qëllim të lehtësimit të operacioneve të pagesave vendore përmes sistemit bankar. AQBK-ja jo vetëm që operon dhe mbikëqyr SEKN-në, por gjithashtu merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në operacionet e SEKN-së bashkë me të gjitha bankat komerciale. Vëllimi dhe vlera e transaksioneve të përshkuara përmes SEKN-së janë rritur në mënyrë të vazhdueshme, duke pasqyruar rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besimit në sistemin bankar vendor. Ndërkohë, SEKN-ja i është nënshtruar zhvillimit të vazhdueshëm teknologjik përdërisa mënyrat e kryerjes së transaksioneve janë modernizuar dhe pasuruar.

Figura 44: Vëllimi dhe vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së




Burimi: AQBK (2008)

Sikurse viteve të mëparshme, në 2007, rritja vjetore si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së transaksioneve të SEKN-së ishte e dukshme. Gjatë vitit 2007, rreth 1.3 milionë transaksione me një vlerë të përgjithshme prej 2.5 miliardë euro janë kanalizuar përmes SEKN-së. Krahasuar me transaksionet e SEKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve u rrit për 33 për qind, dhe vlera e transaksioneve u rrit për 6 për qind.

Rritja e rëndësishme e transaksioneve të SEKN-së mund të shihet edhe nga të dhënat mesatare ditore. Vlera ditore e transaksioneve të SEKN-së në

vitin 2007 ishte rreth 9.9 milionë euro, krahasuar me rreth 9.3 milionë euro në vitin 2006. Mandej, vëllimi ditor i transaksioneve të SEKN-së në vitin 2007 ishte afro 5.3 mijë, krahasuar me rreth 4.0 mijë transaksione në vitin 2006.


Figura 45: Vëllimi dhe vlera mesatare ditore e transaksioneve të SEKN-së



Burimi: AQBK (2008)

Janë pesë lloje të veçanta të transaksioneve të SEKN-së: 1) prioritare – masive, 2) prioritare – individuale, 3) Kos-Giro, 4) të rregullta – individuale, dhe 5) të rregullta – masive. Nivelet krahasuese të vëllimeve dhe vlerave të tyre për vitet 2007 dhe 2006 janë të paraqitura në figurat e mëposhtme.


Figura 46: Vëllimi vjetor i transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: AQBK (2008)

Pagesat e rregullta përbejnë rreth 90 për qind të transaksioneve të SEKN-së, dhe ato kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale (një-deri te-një) ose si transaksione masive (njëderi te shumë ose shumë-deri te-një). Ato procesohen përmes sesioneve të rregullta të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Duhet përmendur se në vitin 2007, sesioni i tretë i kliringut filloj së aplikuari për shkak të rritjes së vëllimit të transaksioneve të rregullta.

Figura 47: Vlera vjetore e transaksioneve të SEKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: AQBK (2008)

Transaksionet Kos-giro përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu procesohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Ato kanalizohen përmes SEKN-së si transaksione masive (shumë-deri te-një). Përderisa transaksionet e rregullta individuale janë të destinuara për pagesat në përgjithësi dhe pagesat e rregullta masive janë të destinuara për pagesat dhe arkëtimet e entiteteve të ndryshme, transaksionet Kos-giro janë të destinuara për arkëtimet e standardizuara dhe të automatizuara të institucioneve të mëdha faturuese. Skema e transaksioneve Kos-giro është futur në përdorim dy vite më parë dhe pati një zhvillim të rëndësishëm në vitin 2007. Një rritje e rëndësishme e transaksioneve Kos-giro për sa u përket vëllimit dhe vlerës, siç është paraqitur më lartë, është si rrjedhojë e bashkimit të Shërbimit Doganor në skemë në vitin 2007. Departamenti i Sistemeve të Pagesave Ndërbankare ka vazhduar të nxitë përdorimin e mëtejshëm të skemës Kos-giro, dhe përmirësime janë bërë lidhur me transaksionet Kos-giro të KEK-ut.

Përgatitjet janë bërë gjithashtu për institucionet e sektorit të sigurimeve që do t'i bashkohen skemës.

Transaksionet prioritare procesohen dhe shlyhen menjëherë në baza bruto. Ngjashëm me transaksionet e rregullta, transaksionet prioritare mund të kanalizohen përmes SEKN-së ose si transaksione individuale ose si transaksione masive. Ato ende përfaqësojnë një pjesë të vogël të transaksioneve të gjithmbarshme të SEKN-së. Në vitin 2007, vëllimi i tyre u rrit në mënyrë të rëndësishme në aspektin relativ, por vlera e tyre zbriti në mënyrë të konsiderueshme. Me sa duket, ky zhvillim lidhet me futjen në përdorim të sesionit të tretë i kliringut në vitin 2007 (pas futjes në përdorim të sesionit të dytë në vitin 2006) që ka mundësuar ekzekutimin e transaksioneve të rregullta disa herë gjatë ditës dhe bëri që transaksionet e SEKN-së të llojit prioritar të përdoren kryesisht për pagesat e paparashikuara ose shumë urgjente të publikut.

Pesë llojet e veçanta të transaksioneve të SEKN-së mund të grupohen në dy kategori varësisht nëse shlyhen në baza neto ose bruto siç u përmend më sipër. Transaksionet e shlyera në baza neto vazhdojnë të dominojnë mbi transaksionet e shlyera në baza bruto. Sa i përket vëllimit, transaksionet e shlyera në baza bruto, përkundër rritjes së tyre vjetore në vitin 2007, vazhdojnë të përfaqësojnë më pak se një për qind të transaksioneve të SEKN-së. Sa i përket vlerës, transaksionet e shlyera në baza bruto janë zvogëluar në mënyrë të ndjeshme në vitin 2007 por vazhdojnë të përfaqësojnë më shumë se pesë për qind të transaksioneve të SEKN-së.

Si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në SEKN, AQBK-ja merr pjesë në kanalizimin e urdhërpagesave vendore në emër të dhe për llogari të llogarimbajtësve. Gjatë vitit 2007, AQBK-ja ka dërguar përmes SEKN-së mbi 130 mijë urdhërpagesa shkuarëse, dhe ka pranuar 90 mijë urdhërpagesa ardhëse. Shprehur në vlerë, shuma e urdhërpagesave shkuarëse në vitin 2007 ishte pothuajse 0.7 miliard euro, dhe vlera e urdhërpagesave ardhëse ishte mbi 1.0 miliard euro. AQBK-ja ka mbetur sa i përket si vlerës ashtu edhe vëllimit të transaksioneve pjesëmarrësi më i madh në SEKN.